




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština -Municipality of Prishtina**



**KOMUNA E PRISHTINËS**

**KRYETARI I KOMUNËS**

**01-020/04-0035630/17, më 22.02.2017**

Në bazë të dispozitave të neneve 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L - 040 për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershori 2008) dhe të dispozitave të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të datës 25.2.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, më 22.02.2017, merr këtë

**V E N D I M**

**I.** Miratohet Vendimi për caktimin e Grupit punues për projektin SoRI, në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të Komunës së Prishtinës dhe organizatës "Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit" GIZ - GmbH.

**II.** Grupi Punues i cekur në pikën I të këtij vendimi është në këtë përbërje:

1. **Premtime Preniqi**, Njësia komunale për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore - koordinatore,
2. **Lulzim Vrapca**, Zyra për Komunitete dhe Kthim, anëtar,
3. **Hyzri Bunjaku**, Drejtoria e Arsimit, anëtar,
4. **Vebi Mujku**, Qendra për Punë Sociale, anëtar,
5. **Muhamed Abdyli**, Komisioni Komunal për Riintegrin, anëtar,
6. **Igballe Përçuki Tahiri**, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, anëtare,
7. **Admir Shala**, INPO, anëtar.

**III.** Detyrat e Grupit Punues janë:

- a) Ndërmarrja e aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve në nivel komunal të të gjithë akterëve për identifikimin, arritjen dhe qasjen tek grupet më të prekura të popullsisë në komunat përkatëse;
- b) Ndërmarrja e aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve në nivel komunal të të gjithë akterëve për të drejtat e njeriut, respektivisht të drejtat sociale;
- c) Asistimi në formimin dhe funksionimin e grupeve punues ndërsektoriale në nivel komune sipas termave të referencës që do të përcaktohen për këtë grup;

- d) Asistim në ofrim cilësor të të gjitha shërbimeve për grupet më të prekura (fushat dhe temat e trajnimit do të identifikohen ndërmjet GIZ-it dhe Komunës);
- e) Ngritje të kapaciteteve për identifikimin, aplikimin dhe implementimin e fondeve për ofrimin e shërbimeve të ndryshme në nivel komunal;
- f) Asistencë në rrjetëzimin dhe bashkëpunimin me OJQ të ndryshme vendore dhe rajonale;
- g) Përkrahje për shërbimet në terren dhe aktivitetet vetëdijesuese (duke përfshirë këtu edhe shpërndarjen e informatave dhe kampanjave vetëdijesuese);
- h) Asistencë në shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira në kuadër të arritjes dhe qasjes në grupet e prekura, por edhe ofrimin e shërbimeve sipas nevojës për këto grupe;
- i) Monitorimi i aktiviteteve të parapara, ndryshimi apo përshtatja sipas kërkesave në terren.

**IV.** Për kryerjen e detyrave në pikën III të këtij vendimi, Grupi punues i raporton Kryetarit të Komunës.

**V.** Grupi Punues zgjedh kryesuesin e Grupit, i/e cila do të kujdeset për koordinimin e aktiviteteve të Grupit.

**V.** Mandati i Grupit Punues është deri më 31 Dhjetor 2018.

**VI.** Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi 01. nr. 031 - 49267, i dt. 22.02.2016 dhe vendimi për ndryshimin e vendimit 01. nr. 031 - 88418, i dt. 29.03.2016.

**VII.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij.

U dorëzohet:

- Anëtarëve të Grupit Punues dhe
- Qendrës për Shërbim me Qytetarë.

